



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 559 Prot.

Roskovec, më 30.01 2023

VENDIM

NR 1 .DATË 27.01 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN DHJETOR 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 23.12.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Dhjetor 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Kadri Hyska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 10972/1 Prot.

Roskovec, më 27.12.2022

Procesverbal Nr.13

-I mbajtur sot, date 23.12.2022, ora 12³⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Nëntor 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Nëntor 2022.
5. Për miratimin e Bursave të shtetit për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike për vitin shkollor 2022-2023.
6. Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në Nr.770 datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec”.
7. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
8. Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve vartëse, për vitin 2023.
9. Për miratimin e Buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2023.
10. Për miratimin e dokumentit të PBA përfundimtar 2023-2025.
11. Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit Buxhetor për vitin 2023.
12. Për ngritjen e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Roskovec.
13. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”.
14. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12⁴⁰

Keshilltaret prezent: A. Kola, E. Çepele, Rr. Hazizi, L. Goga, B. Çobo, K. Hyska, G. Hoxha, V. Dogani, A. Sheme, H. Beqiraj, B. Toska, M. Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : V. Mata, L. Hoxha, B. Kuka, T. Kuka, A. Hazizi, D. Hoxha, V. Bakaj

Prezent nga bashkia: Nenkryetari M. Goga, Dr. Urbanistikes, Dr. Finances, P/Sherbimit Social, P/Dr. Juridike, Sp/Dr. Juridike.

Me plotesimin e kuorumit ,kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 12 keshilltare.Para se te filloje me rendin e dites,Kryetari ben me dije se kemi nje materjal shtese sot,te cilin duhet ta fusim ne rendin e dites “Për përditësim në listën e inventarit,miratuar me VKM-në Nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Kurjan, Bashkia Roskovec”.E hedh ne votim per ta shtuar ne rendin e dites dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.Kryetari i falenderon dhe fillon mbledhjen.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesen e bere si me siper dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Nentor 2022.

Informacioni ka te bej me vendimet e miratuara ne mbledhjen e kaluar.Kishim nje akt normativ “Paketa Fiskale 2023” e cila eshte konfirmuar nga Prefektura.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Nentor 2022.

Elmazi-ka ndonje shtese per Ndhimat Ekonomike,si vepohet me personat qe nuk perfitojne nga skema e ndihmes ekonomike?Sidorela-nese nuk plotesojne piket,ne i fusim ne 6%.Elmazi-nje nga anetaret e keshillit ka pas nje ankese,eshte mbyllur si ankese?Sidorela-po keshilltarja u terhoq nga ankesa.Hidhet ne votim dhenia e ndihmes ekonomike nga fondi 6% per muajin Nentor dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

5. Për miratimin e Bursave të shtetit për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike për vitin shkollor 2022-2023.

Sek.Keshillit sqaron projekt-vendimin per dhenien e Bursave per nxenesit e vitit te pare,ne shkollat e mesme profesionale.Sqaron kerkesat e paraqitura nga prinderit e nxenesve dhe drejtoria e shkolles “Rakip Kryeziu”.Ne total kemi 6 kerkesa te cilet i plotesojne kriteret sipas vkm-se nr.666.Ministria fillimisht na ka derguar 5 bursa,pas kerkeses qe une i bera zyrtarisht,na dergoi edhe 3 bursa te tjera,pra kemi 8 bursa ne total.Nga kerkesat e paraqitura 4 nxenes vazhdojne mesimin ne shkollen “Petro Sota” Fier,dhe 2 nxenes ne shkollen “Rakip Kryeziu”Fier.Hidhet ne votim dhenia e Bursave te Plota nxenesve Xh.Faslliu,L.Kapo,S.Toska,B.Tafa,P.Velmishi,M.Muhametaj sipas kriterëve perkatese dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

6. Për përditësim në listën e inventarit,miratuar me VKM-në Nr.770 datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec”.

Dr.Urbanistikes E.Hoxha sqaron projektin e paraqitur.Maksi-bashkia bashke me keshillin,jane 2 projekte kryesore qe ne kemi marr si inisiative,dhe kjo toke do sherbeje per kete gje.Kadriu-ku ndodhet kjo toke?Eneida-sqaron zonen kadastrale ku ndodhet toka.Elmazi-ku ndodhet kjo toke,kush e ka dhe a ka pronar?Ndodhet e lire kjo toke?Leksi-ky 2 Ha eshte me certificate pronesie?Maksi-eshte ne perdorim dhe do e kalojme me certificate pronesie.Pra aktualisht jane 30 Ha toke bujqesore ne perdorim te bashkise Roskovec,dhe nepermjet vendimit 2 Ha e kesaj toke do kaloj ne pronesi te bashkise Roskovec.Eneida sqaron procedurat ligjore qe do ndiqen per kalinim e kesaj toke ne pronesi te bashkise.Nuk ka me diskutime.Hidhet ne votim perditesimi i listes se

inventarit,miratuar me vkm nr.770 “Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike,shtetore qe transferohen ne pronesi ose perdorim te bashkise Roskovec”sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

7. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.

Dr.Finances sqaron projektin.Do shlyhen detyrimet e prapambetura me kete fond,eshte i percaktuar se perse do perdoret.Elmazi-sa % e ul borxhin e bashkise kjo shume?Selmani-e ul 15-17 % borxhin.Nuk ka diskutime me.Hidhet ne votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

8. Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve vartëse,për vitin 2023.

Maksi-jemi munduar qe ne baze te vkm-se se fundit ti rrisim pagat 7%,pa kaluar ne nivelin maksimal te pages.Drejtorat,pergjegjesat,specialistet kane rritje rroge,kemi punuar me te njejtin standart per te gjithë.Kadriu-po per punetoret sa rritje ka?Maksi-eshte bere sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave.Elmazi-me vjen mire qe paga mesatare e te gjithë punonjesve te rritet,por te shikohet aftesia e punonjesve qe ta meritojne ate page qe marrin,te kene edukat pune me qytetaret.Jam plotesisht dakort se i shikoj edhe vet vuajtjet e tyre per punetoret e ndermarrjeve,se kam qene dhe vet punetor.Ata i heqin me dore mbeturinat,nese keni mundesi punonjesve te ndermarrjeve u jepni ndonje shperblim.Maksi-jemi munduar te gjejme nje mundesi per tu dhene nje shperblim atyre punonjesve.Elmazi-keni bere shume mire nese e keni menduar ta beni kete gje.Hidhet ne votim niveli i pagave te punonjesve te bashkise dhe Ndermarrjeve vartese dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro niveli i pagave per 2023.

9. Për miratimin e Buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2023.

Maksi-sqaron se eshte rritur numri maksimal i punonjesve ku ndikon pika e kompostimit,cerdhja dhe 2 punonjes ne bashki.Selmani-sqaron projekt-buxhetin,sqaron dhe ndryshimet e bera te cilat dolen nga mbledhja e komisionit te ekonomise.Elmazi-tek numri i punonjesve,nese bejme ulje apo ngritje te numrit te punonjesve,nese ka mundesi te merren ata punonjes qe bejne punen,organikat jane te ardhura nga qeveria nuk nderhyjme dot ne,se ne jemi korrekt ndaj ligjit,ndaj une jam me mendimin ta kalojme.Leksi-ne kemi kaluar disa mbledhje me para per 2 pastruese dhe nuk jane bere?Maksi-jane bere.Leksi-nga mbledhja qe bem me komisionin e ekonomise,une ndjej nje kenaqesi te vecante qe fillon pjesa e fushes se sportit,e shoh kete gje tek shpronesimi,dhe kjo tregon se do mari jete ceshtja e stadiumit.Ndjej kenaqesi qe buxheti ka te reflektuara te gjitha kerkesat qe kane dale nga degjesat publike dhe eshte per tu pergezuar bashkia.Maksi-kemi parashikuar edhe rrethimin e disa fushave te sportit dhe sistemimin e tyre.Bujari-pyet per investimin e catise se shkolles “Alush Grepcka”.Shperndarja e investimeve,shikoj nje pakenaqesi ne shperndarjen e investimeve,i keni kushtuar vemendje shperndarjes se fondeve?Kerkoj me insistim 20% nga FSHZH per Luarin,ku vajti ky 20%?Selmani-ai eshte financim total i fondit te zhvillimit,ne nuk futemi dot.5% eshte i ngrire ne degen e thesarit.Maksi-sa i perket diskriminimit te njesive,ne jemi munduar qe sipas kerkesave nga degjesat publike,jemi munduar te futemi ne cdo fshat sipas mundesive qe kemi.Ne do e rishikojme edhe njehere buxhetin ne Maj-Qershor.Jemi te hapur qe ta rishikojme ne muajt pasardhes,por ky buxhet eshte ne baze te degjesave publike.Bujari-une nuk jam dakort me shperndarjen e fondeve,me duket e padrejte kjo shperndarje,per Luarin e kam fjalen,ik shikojeni rrugen si eshte bere.Maksi-ajo rruge eshte ne proces ska mbaruar akoma rruga e Kerranjakeve.Aleksander-jam pak i paqarte me keto qe tha Bujari per Luarin.Kadriu-

tenderi eshte tjeter dhe buxheti eshte tjeter,ju po i ngaterroni.Maksi-per tenderat ka instanca qe merren si prokuroria,gjykata,Spaku.Selmani shpjegon me detaje pasqyrat e buxhetit me zerat perkates,duke futur edhe ndryshimet qe dolen nga mbledhja e komisionit te ekonomise per 3 objekte dhe fondin e banesave.Nuk ka me diskutime.Hidhet ne votim Buxheti,numri maksimal i punonjesve te bashkise dhe ndermarrjeve vartese per vitin 2023 bashke me ndryshimet e bera,dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

10.Për miratimin e dokumentit të PBA përfundimtar 2023-2025.

Dr.finances sqaron projekt-vendimin.Tabelat e PBA per 2023-2025 i keni edhe tek buxheti.Selmani sqaron tabelat sipas zerave perkatese.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim dokumenti i PBA perfundimtar 2023-2025 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

11. Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit Buxhetor për vitin 2023.

Selmani-jane percaktuar sipas ligjit datat kur bejme degjesat,kur pergatiten kerkesat,dokumentat,kur kalojne per miratim ne keshill,Ministri etj.Eshte nje kalendar sipas percaktimeve ligjore.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim kalendar i menaxhimit buxhetor per 2023 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

12. Për ngritjen e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Roskovec.

Drinalda sqaron projektin e ngritjes se komisionit te strehimit.Sipas ligjit hapi kryesor eshte ngritja e komisionit te strehimit sic e keni me 7 anetar,qe do te shqyrtoj dhe marr vendime ne lidhje me kerkesat e paraqitura,asistohet nga nje sekretariat administrativ gjate veprimtarise se tij.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim ngritja e komisionit te strehimit sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

13. Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese,deri në një ndërtim të ri”.

Drinalda-klasifikimi i kerkesave do behet sipas sistemit te pikezimit dhe kriterëve te percaktuara ne ligj.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht ne 12 vota pro.

14.“Për përditësim në listën e inventarit,miratuar me VKM-në Nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Kurjan, Bashkia Roskovec”.

Eneida Dr.Urbanistikes sqaron projektin e shtimit ne inventar te varrezave ne lagjen Kurtaj,fshati Ngjeqar.Shtohen sepse eshte terren i papershtatshem dhe fiset jane larg varrezave.Elmazi-keshilli duhej te gjykonte dhe shikonte,u lutem keshilltareve qe mendoni per ata qe nuk jane me midis nesh,ne te gjitha varrezat te shikohet dhe gjykohet dhe te koloje prona e varrezave qe u takon.Alketi-e kemi ngritur shume here kete problemin e ujit tek varrezat.Kadriu-e kemi kaluar kete gje.Elmazi-ne te gjitha varrezat e fshatrave,drejtore perkatese duhet te shikojne,qe te kaloj prona qe u takon varrezave.Nuk ka me diskutime.Hidhet ne votim projekti i perditesimit ne listen e inventarit te pronave te paluajtshme publike,shtetërore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Komunes Kurjan sipas vkm 108 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

15.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Maksi-I kemi dhene zgjidhje vendparkimit per invalidet,per vendstrehimin e postes u kemi derguar shkrese postes.Elmazi-per tabelat e sinjalistikes brenda qytetit nuk eshte bere asgje,ato nuk kushtojne shume dhe kane te bejne me jeten e njerezve.Posta e Policise,kush i kontrollon lagjet,njesite dhe cfare kontrollohet?A kane mjete per te kontrolluar?Kerkoj informacion nga policia mbledhjen tjeter.Nese si kane mjetet a ka detyrim bashkia per ti ndihmuar,qe ti vijne ne

ndihme qytetareve kur ndodh nje fatkeqesi?Nuk ka me diskutime.Kryetari i falenderon dhe ju uron nje vit sa me te mbare,dhe festa te gezuara per te gjithë.Mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

